



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 30 datë 22.04 2026

PËR DHËNIE TITULLI “MIRËNJOHJE E QYTETIT PËRMET”

Në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Neni 54 pika m, Neni 55 e në vijim, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Vendimi Nr.647 datë 31.12.2025 i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit, Ligji Nr.94/2022 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë, nenet 8 e në vijim, si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” Këshilli Bashkiak, me propozim të Kryetares së Bashkisë:

VENDOSI

1. T'i japë titullin “Mirënjohje e Qytetit Përmet” z. Carsten Schneider.

Motivacioni: “Për kontributin e rëndësishëm në mbështetjen dhe zbatimin e projektit ‘Green Vjosa’, për rolin në forcimin e partneritetit ndërkombëtar për mbrojtjen e Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa, si dhe për ndikimin e drejtpërdrejtë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e potencialit turistik, fuqizimin e komunitetit lokal dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Bashkinë Përmet dhe zonat përreth saj.”

2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI